



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:130051
Datë: 25.09.2024
Numri i dokumentit: 06206300

C-III.-12-1704

Paditësi:

1.M R M– nga Fshati L, Malishevë

Kundër

E paditura:

- 1.NSh “Mirusha” – Malishevë**, përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr.55 , Prishtinë,
- 2. Komuna e Malishevës** – Malishevë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga kryesuesja e kolegjit Hajrie Shala gjyqtare dhe anëtarët e kolegjit Agron Hoxhaj dhe Bajram Miftari gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me dt.16 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Procedura në këtë çështje juridike NDËRPRITET për shkak të vdekjes së paditësit M M.**
- 2. Procedura do të vazhdohet kur trashëgimtarët e të ndjerit kërkojnë vazhdimin e procedurës.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësi ka paraqitur padi më 22.08.2007 mbi pretendimet pronësore mbi ngastrën kadastrale në vendin e quajtur “..” në sipërfaqe prej 0,60.00 ha, e cila tani është pjesë përbërëse e ngastrës nr. P.. e evidentuara në fletën posëduese nr., ZK Malishevë. Në padi i njëjti deklaroi se është trashëgimtarë i paraardhësit R. (S.)M. ish nga Malisheva, i cili deri në vitin 1960 ishte pronar juridik i ngastrës kadastrale në vendin e “Rr.” në sipërfaqe prej 0,60.00 ha.

Paditësi deklaroi se paraardhësit të tij i është marrë në vitet e 50-ta ngastrëa kontestuese dhe për këtë i është dhënë një ngastër tjetër në shfrytëzim por në vitin 1960 ky ndërrim ishte shfuqizuar kështu që pronarit-tarshëgimlënsit i është kthyer posedimi faktik i ngastrës. Nga ajo kohë edhe deri më sot paditësi e shfrytëzoi këtë ngastër kadastrale.

Me 03 korrik 2023, e paditura AKP ka parashtruar përgjigjen në padi e cila në tërësi e kundërshton padinë e parashtruar nga paditësi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, si të pa bazuara në ligj.

Më 16 shtator 2024, gjykata mbajti senacën dëgjimore me të cilën u konstatua se paditësi M M ka vdekur dhe në sallë ka prezantuar djali i të ndjerit R(M) M ndërsa, sa i përket Komunes së Malishevës nuk ka prezentuar askush edhe për kundër faktit që ishte e ftuar në mënyrë të rregullt.

I biri i të ndjerit M M –R theksoi se edhe përkundër faktit që ka pranuar urdhërin nga gjykata për të siguruar Aktvendimin e Trashëgimisë ai nuk ka mundur ta sigurojë sepse se tani janë familje e madhe dhe disa prej tyre janë jashtë vendit .

Arsyetimi ligjor

Procedura në këtë çështje juridike ndërpritet për shkak të vdekjes së paditësit M R M.

Sipas nenit 76 par.3 të Ligjit Nr.06-L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parasheh: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.”*

Kurse, sipas dispozitës së nenit 277 pika (a) të LPK-së: *Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale.*

Në vazhdim dispozita e nenit 280 par. 1 të LPK-së parasheh: *“Procedura që është ndërprerë për shkak të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë.”*

Përkundër faktit se Gjykata caktoi dy seanca, duke i dhënë mundësin djalit të paditësit që të vërtetoi se është trashëgimtar ligjor i paditësit tani të ndjer, i njëjti nuk e dorëzoi vendimin e trashëgimisë për të vazhduar procedurën andaj, gjykata pas shqyrtimit ndërpreu procedurën, deri në një kërkesë për vazhdim të saj.

Andaj, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 277 pika (a) dhe nenit 280 par. 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Hajrie Shala, Gjyqtare kryesuese

Agron Hoxhaj, Gjyqtar

Bajram Miftari, Gjyqtar